



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 53 Prot.,

Tiranë, 01.03 2024

VENDIM

Nr. 45, datë 01.03.2024

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 01.03.2024:

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit të Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të projektit “Kompleks rezidencial me vila banimi dhe shërbime me vila 2 – 3 kat”, Zona Kadastrale 2529, Lundër, me vendndodhje pranë ‘TEG’, Bashkia Tiranë, me zhvillues subjekti **PERAG sh.p.k.**;
2. Gjatë procesit të zbatimit, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, datë 17.05.2018, neni 72, pika 1 dhe 2 dhe nëse ndeshen gjetje rastësore, punimet të ndërpriten menjëherë dhe të raportohen pranë IKTK-së, referuar nenit 145 - 147;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
4. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Klesta QIRICI



KRYETAR
Blendi GONXHJA